

Raport lidhur me Projektet zhvillimore dhe Linjën e 10 hekurudhore për periudhën (korrik – gusht) 2020.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS, përveç angazhimeve tjera të përditshme në realizimin e detyrave të parapara një vëmendje të posaçme ia ka përkushtuar edhe projekteve zhvillimore të cilat janë të një rëndësie të veçantë. Projektet zhvillimore të INFRAKOS-it në ekzekutim e sipër gjatë periudhës raportuese janë:

1. Rehabilitimi gjeneral i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)
2. Projekt dizajni preliminar për Linjën e 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Prishtinë – Podujevë – Kufiri me Serbinë)
3. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Linjës Hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës)
4. Ndërtimi i vendkalimeve elektrike në Linjën Hekurudhore (Fushë Kosovë – Pejë)

1. Rehabilitimi gjeneral i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)

Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 1: (Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)

Gjatë kësaj periudhe kohore është zhvilluar një numër i madh i aktiviteteve rreth vazhdimit dhe përsheptimit të punëve për rehabilitimin e fazës së parë të Linjës së 10-të hekurudhore me ç'rast janë hapur disa fronte pune përgjatë kësaj linje hekurudhore. Një mbështetje e madhe për këtë projekt e ka bërë edhe Ministri i Infrastrukturës z. Arban Abrashi i cili në vizitën e datës 11.08.2020 në punishten e stacionit në Miradi kërkoj nga punëkryesi që të shtohet vëllimi i punëve për realizimin e këtij projekti në afatin e paraparë.

Punët e realizuara në këtë periudhë kohore kanë qenë dukshëm më të mëdha sesa deri më tani dhe që nga fillimi i rehabilitimit me datën 31.08.2019, tani për herë të parë po shihet një aktivitet tërësisht ndryshe nga e kaluara.

Meqenëse tanimë ka filluar edhe demontimi i binarëve të vjetër ne me datën 14.08.2020 kemi formuar komisionin e ekspertëve i cili do të bënë deponimin e materialeve të demontuara, ndërsa me datën 20.08.2020 kemi përfunduar Udhëzimin mbi deponimin e materialeve të demontuara gjatë punimeve në rehabilitimin e linjave hekurudhore. Në të njëjtën kohë është bërë skicimi i

hapësirave se ku do të bëhet deponimi i materialeve, kështu që me këtë kemi bërë të gjitha parapërgatitjet e nevojshme për depozitimin e materialeve të cilat do të demontohen gjatë rehabilitimit të Linjës së 10-të hekurudhore.

Për ilustrim më të mirë, në vijim janë prezantuar edhe me fotografi punët e kryera gjatë këtij dymujori:

Dërgimi i materialit - Kontraktuesi GCF ka vazhduar me shkarkimin dhe magazinimin e traversave të betonit në hapësirat e stacionit Miradi dhe atë 8448 copë traversa betoni të gjatësive (7200 L=2,60m dhe 1248 L=2,40m):



Magazinimi i traversave të betonit nga GCF



Montimi i pjesëve lidhëse në traversat e betonit nga GCF

Punët tokësore - Kontraktuesi ka realizuar punime në Stacionin Miradi, gërmime të materialit tokësor dhe gjysmë shkëmbor nga linja kryesore dhe ndërtimin e argjinaturës anësore kudo që ka qenë e nevojshme.



Gërmimi i dheut dhe gjysmë shkëmbor



Ngjeshja e bazës së nënshtresës



Mbushja e Platformës



Gërmimi dhe ngjeshja e kanalit të djathë

Punët në Trase - Kontraktuesi ka demoluar binarët ekzistues S49 nga traversat e drurit, ndërruesen 1 dhe 3 duke e larguar edhe balastin në vende të ndryshme të prezantuar në tabelën si më poshtë dhe vendosjen e përkohshme të balastit në depo.



Largimi i balastit ekzistues



Vendosja e balastit në depo të përkohshme



Prerja e binarëve S49 nga traversat



Demontimi i ndërrueseve

Punët e Drenazhimit - Kontraktuesi ka realizuar punime në Lëshesën C006 në kilometrin 251 + 537.23, Lëshesën C004 në kilometrin 251 + 537.23, Lëshesën C0015 në kilometrin 258 + 160.92, kanalin anësor majtas nga km. 250 + 940 - 251 + 300 dhe kanalin anësor nga km. 250 + 940 - 251 + 304.65. Në këto punime janë realizuar aktivitete si më poshtë:

- Gërmimet e kanaleve anësore;
- Derdhja e betonit për pllaka, mure dhe mure anësore për C006;
- Instalimi i kornizave për C006;
- Heqja e kornizave për C006;
- Gërmimi për C004; dhe
- Gërmimi për C015.



Kanali anësorë km. 250+940 – 250+300



Betonimi km. 250+940 - 251+304.65.



Lëshesa C006 në kilometrin 251+537.23



Lëshesa C004 në kilometrin 251+537.23



Lëshesa C015 në kilometrin 258+160.92

Muret Mbrojtëse – Ndër punët e realizuara gjatë këtyre dy muajve është edhe ndërtimi i mureve mbrojtëse të cilat janë prezantuar në tabelën vijuese:

Përshkrimi	Kilometri fillimi	Kilometri fundi	Gjatësia (m)
Muri 2 - djathtas	247+100.00	247+160.00	60.00
Muri 3 - djathtas	247+820.00	247+860.00	40.00
Muri 1 - majtas	247+100.00	247+975.15	875.15
Muri 2 - majtas	249+531.87	249+921.70	389.83
Muri 3 - majtas	250+100.00	250+420.00	320.00



MB 2D në km. 247+100.00 - 247+160.00



MB 3D në km. 247+820.00 + 247+860.00



MB 1M në km. 247+100.00 - 247+975.15



MB 2M në km. 249+531.87 - 249+921.70



MB 3M në km. 250+100.00 - 250+420.00

Rregullimi i shtratit të lumit - Kontraktuesi ka filluar me rregullimin e shtratit të lumit rreth urave 15,16,17,18,19 dhe 20 në rrethinën e Kaçanikut.



Ura 15 - rregullimi i shtratit të lumit



Ura 16 - rregullimi i shtratit të lumit



Ura 17 - rregullimi i shtratit të lumit



Ura 18 - rregullimi i shtratit të lumit



Ura 19 - rregullimi i shtratit të lumit



Ura 20 - rregullimi i shtratit të lumit


Stacionet dhe Vend ndaljet - Kontraktuesi gjatë kësaj periudhe po ashtu ka vazhduar të punojë për ndërtimin e platformës në Stacionin Miradi dhe vend ndaljen Hashanaj. Platforma në Stacionin Miradi ka një gjatësi totale prej $L = 200$ m e cila ndahet me nyje 2 cm në 16 pjesë të barabarta me gjatësi 12.50 m. Platforma ka formën e kutisë me pllakë dhe trashësi muri prej 0.20 m.

Do të ndërtohen dy rampa të reja për t'i shërbyer personave me lëvizshmëri të kufizuar. Të dy rampat përbëhen nga dy pllaka dhe tre mure, një rampë ka gjatësi 7.70 m dhe lartësia e saj ndryshon nga 1.57 m në 1.35 m, ndërsa e dyta ka gjatësi totale 7.70 m me lartësi të ndryshme nga 1.35 m në 1.14 m. Të dy rampat janë të gjëra 1.65 m. Vend ndalja Hashanaj ka një gjatësi totale $L = 100$ m: Punimet e realizuara janë si më poshtë:

- Punime prej betoni për pllakën e poshtme dhe muret vertikale të platformës;
- Instalimi i shufrave prej çeliku përforcues B 500 C për pllakën e poshtme dhe muret vertikale të platformës;
- Veshje bituminoze;
- Përfundimi i platformës;
- Gërmimet për platformë në vend-ndaljen Hashanaj;
- Shtrirja e shtresës së poshtme për themele dhe Platformë; dhe
- Derdhja e betonit të varfër C 12/15.

Gjatë këtyre dy muajve ka vazhduar puna intensive për realizimin e punëve në platformën e stacionit Hekurudhor të Miradisë. Punimet e Platformës në Stacionin Miradi janë realizuar nga kilometri 251 + 304.65 deri në kilometrin 251 + 504.65.

Në mënyrë që të bëhet pasqyrimi i këtyre punëve të realizuara rreth platformës në Stacionin Hekurudhor të Miradisë dhe vend-ndalimin në Hashanaj, në vijim është bërë prezantimi i disa fotografive përmes të cilave shihet realizimi i punëve në këtë periudhë kohore.



Instalimi dhe përforcimi i kornizave



Veshja e dyfishtë me bitumen



Mbushja e Platformës



Instalimi dhe përforcimi i mbulesës



Punët përgatitore dhe gjurmimi i platformës në Hashanaj në km. 258+722 - 258+822





Përgatitja e nënshtresës për betonim



Punët e betonimit me beton te varfër

Rrjeti i kablllove përgjatë linjës hekurudhore - Gjatë punimeve për murin mbajtës 2 Djathtas nga kilometri 247 + 100 - 247 + 160, muri mbajtës 3 majtas km. 250 + 100 - 250 + 400, dhe muri mbajtës 2 majtas km. 249 + 531.87 - 249 + 921.70, kontraktuesi ka hasur në kabllot ekzistuese optike të cilat në disa raste edhe janë dëmtuar gjatë gërmimeve.



Kabllot optike 250 + 100 - 250 + 420 dhe 250 + 100 - 250 + 420



Kabllot me fibër optike Muri 2 majtas km. 249 +531.87-249+921.70

Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 2: (Fushë Kosovë – Mitrovicë)

Pas përgatitjeve të Dokumenteve të Tenderimit dhe finalizimin e Dizajnit, duke i ngarkuar në portalin elektronik të BERZH-it ecepp-ebrd, amendamentimet dhe sqarimet e ofruara për kompanitë e para-kualifikuara, me 08/06/2020 në ora 12:00 sipas kohës lokale UK është mbyllur procesi i ofertimit elektronik dhe në formë elektronike është gjeneruar raporti i hapjes nga i cili është kuptuar se 4 (katër) kompani të cilat ishin në mesin e 9 (nëntë) kompanive të para-kualifikuara kanë dërguar ofertat e tyre dhe janë renditur sipas ofertave financiare.

Për këtë projekt është themeluar komisioni vlerësues dhe i njëjti mbi bazën dhe instruksionet e kompanisë mbështetëse dhe të dokumenteve të BERZH-it për procesin e vlerësimit ka filluar punën dhe është në vazhden e vlerësimit të ofertës. Procesi po shkon me dinamikën e planifikuar, kushtet në të cilat po punon komisioni janë shumë të mira, ndërsa gjatë tërë kohës komisioni mbështetet edhe nga kompania konsulente Egis International e cila me ekspertizën e saj e mbështetë komisionin vlerësues.

Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 3: (Mitrovicë – Leshak – Kufiri me Serbinë)

Kemi realizuar video konferencë me udhëheqësin e konzorciumit të IPF9 për hartimin e Dizajnit të fazës së III (Mitrovicë - Leshak), në këtë VK u shpalosen kërkesat tona dhe pritjet tona nga IPF9, po ashtu u deklarua se jemi të gatshëm që si përfitues me të gjitha kapacitetet të cilat tanimë i kemi ndërtuar dhe përvojën 5 vjeçare të NjIP-PIU të ofrojmë kontributin tonë maksimal dhe të realizojmë detyrat tona në nivelin më të lartë duke u përfshi në të gjitha proceset. Nga kjo VK neve si obligim na mbeti të angazhohemi që të hartohen sa më shpejt që të jetë e mundur Termat e Referencës nga IFICO, gjë që në korrespondencat e fundit me stafin lokal të IFICO-s u dëshmuua se janë në përgatitje të ToR, dhe se shumë shpejt do jetë gati.

2. Projekt dizajni preliminar për Linjën e 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Prishtinë – Podujevë – Kufiri me Serbinë)

Përveç linjës së 10 hekurudhore, INFRAKOS-i është i interesuar edhe për rehabilitimin e linjave tjera hekurudhore, ashtu që të kemi një rrjet hekurudhor i cili do t'i plotëson standardet e BE-së. Në këtë drejtim është arritur që të përfitojmë 1.25 milion euro grante të WBIF-it me të cilat kemi filluar të bëjmë hartimin e projekt dizajnit preliminar për rehabilitimin gjeneral dhe modernizimin e linjës së 7-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Podujevë – Prishtinë - Fushë Kosovë).

Ky projekt dizajn është në përfundim e sipër, ndërsa afati i përfundimit varet nga situata në teren për shkak të pandemisë me COVID 19. Pas përfundimit të këtij projekt dizajni preliminar do të krijohen kushtet për bisedime me institucionet financiare ndërkombëtare për gjetjen e mundësive të financimit për realizimin e rehabilitimit gjeneral edhe të kësaj linje hekurudhore e cila është me rëndësi të madhe për lidhjen e Kosovës me vendet e rajonit dhe më gjerë.

Ngjashëm me Linjën e 10-të Hekurudhore mundësia e investimeve dhe granteve të BE-së edhe për Linjën e 7-të hekurudhore është e madhe pasi që e njëjta i përket zgjerimit të rrjetit gjithëpërfshirës të Rrjetit Trans Evropian të Transportit (TEN-T). Prandaj kjo paraqet një shans shumë të mirë për tërheqjen e investimeve dhe granteve të BE-së.

Deri më tani, ekipi i ekspertëve ka paraqitur analizën e opsioneve teknike (përfshirë raportin teknik dhe vlerësimet e kostos, planin e përgjithshëm, planet horizontale / gjatësore për secilin opsion, performancën operative dhe vlerësimin e kapacitetit të linjës paraprake) dhe metodologjinë e MCA-së (analizat e kritereve të shumëfishta).

Ekipi është në kontakt me INFRAKOS për të pritur reagime për çështje specifike (opsione teknike, identifikimin e kontakteve për organizimin e panelit për MCA (Multi Criteria Analysis), dokumente dhe të dhëna si: anekset e Master Planit të Aeroportit, të dhënat për kalimet kufitare, raportet e përkohshme të Planit të Qëndrueshëm të Mobilitetit të Prishtinës, etj.).

3. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Linjës Hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës)

Njëri ndër projektet e infrastrukturës hekurudhore i cili po ashtu financohet nga grantet e Kornizës Investive të Ballkanit Perëndimor (WBIF) është edhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e linjës hekurudhore (Prishtinë – Fushë Kosovë – Aeroporti i Prishtinës), projekt ky i cili është i një rëndësie të veçantë për lidhjen e aeroportit me hekurudhë.

Ky projekt është në zbatim që nga takimi fillestar i datës 10.07.2018. Ekipi ka paraqitur një seri të rezultateve: Draftin e Dizajnit Preliminar (përfshirë alternativat për skemat trasesë dhe vend-ndaljet, propozimin për vend-ndaljet e reja dhe dizajnin e platformave). Raportin e Inspektimit të Urave, Raportin e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social, Raportin e Hidrologjisë dhe Drenazhimit, Dizajnin e Elektrifikimit, Raportin e Shqyrtimeve Gjeodezike, Raportet Gjeo-teknike / Gjeologjike / dhe të shqyrtimit të Strukturave).

Ekipi tani po adreson komentet e marra nga INFRAKOS në rezultate specifike. Sidoqoftë, për të përparuar dhe përfunduar projektin ka të dhëna dhe informacione në pritje që duhet të sigurohen nga INFRAKOS:

- koordinatat gjeodezike të tokës që nuk është në pronësi të INFRAKOS-it në stacionin e Prishtinës,
- reagimi i Komunës së Prishtinës në lidhje me propozimin për nënkalimin e ri në km 119 + 260,
- informata në lidhje me hapësirat e nevojshme për ambientet e reja të INFRAKOS-it në stacionin e Prishtinës, sepse hapësira është duke ndikuar në modelin e ndërtesës.

4. Ndërtimi i vendkalimeve elektrike në Linjën Hekurudhore (Fushë Kosovë – Pejë)

Për projektin “Ndërtimi dhe sigurimi i vendkalimeve hekurudhore” është nënshkruar kontrata me datën 30.10.2018. Kontraktori apo punëkryesi është Grupi i Operatorëve Ekonomik N.T.Sh. “H-PROJEKT” nga Kosova dhe “ALTPRO” d.o.o nga Kroacia.

Kjo kontratë është kontratë kornizë dhe kohëzgjatja e saj është 18 muaj dhe ka përfunduar me datë 30.04.2020. Kjo do të thotë se vetëm deri me datë 30.04.2020 ka mundur të bëhen pors sipas kësaj kontrate, ndërsa kryeja e punëve mund të behet edhe pas kësaj date në përputhje me planin dinamik. Kontrata është nënshkruar në vlerë prej 1,687,454.36 € dhe kjo është kostoja e

ndërtimit të 10 vendkalimeve sipas sasive indikative të parapara me projekt. Mirëpo meqë kjo është kontratë kornizë kostoja e ndërtimit të secilit vendkalim ndryshon dhe llogariten nga sasia e materialeve dhe punëve që ekzekutohen në teren.

Fillimisht është punuar në tri vendkalime hekurudhore:

1. Vendkalimi VK 1 – km 4+840 në Bardh;
2. Vendkalimi VK 3 – km 19+450 në Çikatovë;
3. Vendkalimi VK 4 – km 21+948 në Drenas.

Të gjitha punët në këto tri vendkalime kanë përfunduar dhe këto vendkalime janë pranuar teknikisht.

Më pastaj punët kanë vazhduar në vendkalimin VK2 – km 8+696 në Grabovc. Mirëpo, me datë 03.12.2019, pas përkeqësimit të kushteve atmosferike ekzekutimi i punëve është pezulluar deri në pranverë. Pas përmirësimit të kushteve atmosferike me datë 24.03.2020, kontraktori i është dërguar kërkesë për vazhdimin e punëve të mbetura si dhe fillimin e punëve edhe në tri vendkalime tjera:

4. Vendkalimi në Drenas, km 25+226;
5. Vendkalim në Pejë (tranziti), km 79+00
6. Vendkalimi në Pejë, km 80+842.

Mirëpo kontraktori na është drejtuar me kërkesë që për shkak të pandemisë Covid -19, rifillimi i punëve të shtyhet. Kjo kërkesë është aprovuar nga Menaxheri i Projektit dhe rifillimi i punëve në këto vendkalime pritet të filloj pas përfundimit të pandemisë. Pas lehtësimit të masave kundër pandemisë kontraktori ka shpreh gatishmërinë të vazhdoj me ekzekutimin e punëve të mbetura në vendkalimin VK2 – km 8+696 në Grabovc dhe punët kanë rifilluar me datë 13.07.2020 dhe punët për këtë vendkalim pritet të përfundojnë brenda këtij muaji.

Deri më tani vlera e furnizimeve instalimeve dhe punëve të pranuar dhe faturuara dhe paguara në këtë projekt në total është 541,049.09 €. Vlera e furnizimeve instalimeve dhe punëve të porositura e që pritet të faturohen këtë vit është rreth 588,000 €.

Pagesa e këtyre faturave pritet të sigurohet fillimisht nga Buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës i cili për këtë projekt ka qenë 500,000 €, mirëpo nga projekti i rishikimit buxhetor shihet se është shkurtuar në 250,000.00 €, ndërsa pjesa tjetër e mbetur do të sigurohet nga Ministria e Ekonomisë dhe ambientit nga kodi për projekte kapitale.